

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I KOORDINIMIT NDËRKOMBËTAR PROJEKTEVE DHE KËRKIMIT
SHKENCOR

Nr. 2088 Prot.

Gjirokastrë, më 17.12.2025

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jahid **CANA**



Lënda: Thirrje për aplikime për bursë mobiliteti për mësim për studentët e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm"

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në bashkëpunim me Universitetin e Molises, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Krijimin e një Programi Diplome të Dyfishtë, Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm", fton studentët e këtij programi, të aplikojnë për të përfutur një bursë për mësim për semestrin e dytë të vitit akademik 2025 - 2026 në Universitetin e Molises.

Në përfundim të mobilitetit studentët do të vijnë në studimet në universitetin e tyre të origjinës (UGJ). Ata nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi në universitetin pritës, por do të vazhdojnë të paguajnë tarifat që aplikohen në universitetin e tyre të origjinës (UGJ).

Shpenzimet do të mbulohen nga UGJ në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Krijimin e një Programi Diplome të Dyfishtë.

Numri i bursave të studimit – 2 (dy).

Bursa përfshin:

Kompensimin mujor për të mbuluar akomodimin dhe dietën ditore;

Shpenzimet e udhëtimit në vlerën e biletës.

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

- të jenë studentë të ciklit të parë të studimeve;
- të jenë studentë të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm";
- të zotërojnë njohuri të mira të gjuhës angleze ose italiane.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Merita akademike;
- Kompetenca gjuhësore;

- Prioritet do t'u jepet studentëve që nuk kanë marrë pjesë më parë në mobilitet në të njëjtin cikël studimi;
- Prioritet do t'u jepet studentëve që u përkasin grupeve nga diversitete sociale ekonomike, gjinore, racore, ngjyre, aftësi të kufizuara, etj.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Letër motivimi;
- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash;
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës së kërkuar në marreveshje;
- Letër reference;
- Dokument që vërteton aftësinë e kufizuar;
- Dokument që vërteton që studenti është anëtar i komunitetit rom, egjiptian ose pakicave të tjera;
- Dokument që vërteton që studenti vjen nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike ose bursë nga shteti.

Më shumë informacion rreth Universitetit të Molises do të gjeni në:

<https://www.unimol.it/english/>

Për përzgjedhjen e studentëve ngrihet nga Rektori një komision *ad hoc* i cili vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga studentët.

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor brenda datës 30.12.2025, ora 16:00.

Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor brenda datës 07.01.2026 ora 16:00 në adresën e tyre të email-it.


Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad hoc* pranë Rektorit brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.

Për më shumë informacion rreth mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit, kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.

Universiteti "Eqrem Çabej" ju uron suksese!

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj



Konceptoi: Irma Gjollëshi

